

UDHËZIM
Nr. 8502, datë 24.10.2016

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT
RAJONAL TË ZHVILLIMIT TË
TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 20, pika 4, të ligjit nr. 93/2015, datë 27.7.2015, "Për turizmin",

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit pranë MZHEËTTS, prefekturat e qarqeve dhe Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit për zbatimin e këtij udhëzimi.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi

UDHËZIM
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E KOMITETIT RAJONAL TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

I. Qëllimi dhe objektivat

1.1 Ky udhëzim ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë së Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, bazuar në nenin 20, pika 4, të ligjit nr.93/2015, datë 27.7.2015 "Për turizmin".

1.2 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit bashkërendon punën ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, për çështjet e turizmit.

1.3 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit ka për detyrë:

- të sigurojë një forum për të trajtuar çështjet që lidhen apo që lindin nga veprimtaritë turistike në njësitë e qeverisjes vendore;
- të sigurojë një forum për bashkëpunim, ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe institucioneve të tjera të turizmit në nivel vendor, për çështjet që lindin në fushën e zhvillimit të turizmit, në zbatimin e politikës kombëtare dhe për çështje të tjera të lidhura me këtë fushë;
- të sigurojë informacion për ministrin dhe AKT-në, për çështjet e lidhura me turizmin, që krijohen në njësitë e qeverisjes vendore, sipas territorit administrativ përkatës.

II. Përbërja dhe Funksionimi i Komitetit Këshillimor të Sektorit Privat të Turizmit

2.1 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, krijohet dhe funksionon pranë çdo prefektуре.

2.2 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit pranë çdo prefektуре, ka në përbërje:

- Një përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për turizmin;
- Një përfaqësues nga sektori i turizmit dhe ai i kulturës, i njësive të vetëqeverisjes vendore të përfshira në territorin e qarkut;
- Një përfaqësues nga sektori i turizmit dhe ai i kulturës, të qarkut;
- Dy përfaqësues për secilën nga shoqatat lokale, ose degët rajonale të shoqatave kombëtare, të

cilët operojnë në fushën e turizmit, duke përfshirë ato të hotelierisë, të operatorëve turistikë apo të çfarëdo lloji aspekti tjetër të fushës së turizmit, të cilët operojnë në rajonin e qarkut;

- Një përfaqësues nga institucionet arsimore dhe edukuese për turizmin;
- Një përfaqësues nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura;
- Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare;
- Një përfaqësues nga Agjencia e Zhvillimit të Rajoneve;

2.3 Përbërja nominale e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit pranë çdo prefekturë, caktohet me urdhër të prefektit, mbi bazën e dokumenteve të përfaqësimit të institucioneve

publike, shoqatave dhe organizatave, në përbërje të Komitetit Rajonal sipas përcaktimeve të pikës 2.1.

2.4 Në rast se në territorin e qarkut nuk operojnë shoqata të tilla, prefekti njofton për pjesëmarrje dy përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë.

2.5 Në mbledhjet e Komitetit mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të tjerë të grupeve të interesit apo të institucioneve të tjera, në cilësinë e të ftuarit nga prefekti.

2.6 Në ushtrimin e funksioneve, KRZHT-ja ndihmohet nga sekretaria teknike, e cila kryhen detyrat e përcaktuara në poshtë:

- Njofton anëtarët e KRZHT-së për datën e mbledhjes dhe rendin e ditës;
- Mban procesverbalet e mbledhjeve të KRZHT-së;
- Zbardh vendimet e marra në mbledhje nga KRZHT-ja;
- Menaxhon dokumentacionin e nevojshëm për organizmin e mbledhjes;
- Iu komunikon anëtarëve të KRZHT-së dokumentacionin e disponueshëm, që do të diskutohet në mbledhjen e radhës;
- Dokumenton çdo mendimin, kërkesë apo informacion që përcjellin anëtarët;
- Kryhen çdo detyrë tjetër ndihmëse, që shkon për mirëfunksionimin e KRZHT-së.

2.7 Funksionet e sekretarisë teknike do të

kryhen nga një ose disa persona të caktuar me urdhër të prefektit dhe që janë pjesë e strukturës të prefekturës.

III. Mënyra e funksionimit

3.1 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit pranë çdo prefekturë, është një organizëm kolegjal, veprimtaria dhe funksionimi i të cilit, drejtohet nga prefekti i qarkut.

3.2 Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit pranë çdo prefekturë, si rregull thirret nga prefekti jo më pak se 2 herë në vit, me tematikë të përcaktuar dhe të komunikuar më parë tek anëtarët nëpërmjet sekretarisë teknike.

3.3 Prefekti e thërret mbledhjen në raste të veçanta dhe për tematika që kanë afate kohore të përcaktuara, takimet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit mund të zhvillohen edhe jashtë këtij rregulli.

3.4 Produkti i punës i Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, janë rekomandimet që dalin nga mendimet dhe komentet e shprehura në mbledhjet e tij, të cilat pasqyrohen në formë konkluzionesh në procesverbalin e mbledhjes dhe u përcillen në formë elektronike të gjithë anëtarëve. Këto rekomandime i përcillen me shkrësë zyrtare Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3.5 Me qëllim që rekomandimet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit të jepen të strukturuar dhe kolegjiale, është e nevojshme që aktiviteti i tij, të mos kufizohet vetëm në opinionet dhe idetë e shprehura verbalisht në mbledhjet e rregullta, por anëtarët mund t'i parashtrojnë mendimet dhe idetë e tyre në formë të shkruar, duke ia dorëzuar paraprakisht sekretarisë teknike jo më vonë se 5 ditë pune përpara fillimit të mbledhjes.

3.6 Anëtarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit informohen me shkrim, jo më vonë se 10

(dhjetë) ditë pune përpara mbledhjes, për rendin e ditës dhe çështjet që do të diskutohen. Të gjithë materialet e nevojshme duhet tu vihen në dispozicion anëtarëve të KRZHT paraprakisht nga sekretaria teknike, e cila përgatit nga një kopje për çdo pjesëmarrës, të printuar ose në formë elektronike së bashku me njoftimin për datën, orën dhe vendin e organizimit të takimit.

3.7 Procesverballi i mbledhjes u përcillet në formë elektronike, nga sekretaria teknike, të gjithë anëtarëve, jo më vonë se dita pasardhëse e takimit.

IV. Kodi i Etikës i anëtarëve të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit

4.1 Anëtarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, të gjitha materialet dhe dokumentet (drafte dhe për përdorim të brendshëm) të vëna në dispozicion, nuk mund t'i bëjnë publike në median e shkruar dhe atë vizive.

4.2 Anëtarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit duhet të shmangin tendencat për përfitime personale ose të bizneseve që ata përfaqësojnë, kur diskutohen çështje të veçanta që lidhen me vendimmarrje, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre ekonomike.

4.3 Anëtarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, duhet të diskutojnë me objektivitet dhe të komunikojnë me respekt e duke krijuar mundësinë që secili të shprehë lirshëm mendimet e tij duke i argumentuar ato.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES

Milva Ekonomi